

**Emertimi dhe Forma ligjore**

**NIPT-i**

**Adresa e Selise**

**Data e krijimit**

**Nr. Regjistrimit Tregtar**

**Veprimtaria Kryesore**

**Pati Travel shpk**

**L71422015F**

**Kompleksi Frader, Unaza e Re, Kashar**

**Tirane**

**22.02.2017**

**Transport Kombetar dhe Nderkombetar  
Udhetaresh dhe mallrash**

# **PASQYRAT FINANCIARE**

## **(Njësi ekonomike të vogla)**

**( Ne zbatim te Standartit Kombtar te Kontabilitetit Nr.2 I permiresuar)  
( Ne zbatim te Ligjit Nr.25/2018 Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare)**

**Viti 2020**

Pasqyrat Financiare jane te shprehura ne	<b>LEKE</b>
Pasqyrat Financiare jane te rrumbullakosura ne	<b>0.00</b>
Periudha Kontabel e Pasqyrave Financiare	<b>VITI 2020</b>
<b>Nga</b>	<b>01.01.2020</b>
<b>Deri</b>	<b>31.12.2020</b>
Data e mbylljes se Pasqyrave Financiare	<b>20.03.2021</b>

Shenimet	Periudha Raportuese	Periudha Para ardhese
<b>AKTIVET</b>		
<b>Aktive afatshkurtra</b>		
Mjete monetare	1	253,025
<b>Investime</b>		
<i>Ne tituj pronesie te njesive ekonomike brenda grupit *</i>		
<i>Ne tituj pronesie te njesive ekonomike ku ka interesa pjesmarrese aksione te veta</i>		
<i>Te tjera financiare</i>		
<b>Te drejta te arketueshme</b>	2	
<i>Nga aktiviteti i shfrytezimit</i>		
<i>Nga njesite ekonomike brenda grupit *</i>		
<i>Nga njesite ekonomike ku ka interesa pjesmarrese</i>		
<i>Te tjera</i>	6,952,492	
<i>Kapital i nenshkruar i papaguar</i>		
<b>Inventaret</b>	3	
<i>Lende e pare dhe materiale te konsumueshme</i>		23,688
<i>Prodhime ne proces dhe gjysemprodukte</i>		
<i>Produkte te gatshme</i>		
<i>Mallra</i>	23,772	
<i>Aktive biologjike (gje e gjalle ne rritje dhe majmeri)</i>		
<i>AAGJM te mbajtura per shiite</i>		
<i>Parapagime per inventar</i>		
<b>Shpenzime te shtyra</b>		
<b>Te arketueshme nga te ardhura te konstatuara</b>		
<b>Totali i aktiveve afatshkurtra</b>	<b>11,691,905</b>	<b>276,713</b>
<b>Aktive afatgjate</b>		
<b>Aktive financiare</b>		
<i>Tituj pronesie te njesive ekonomike brenda grupit *</i>		
<i>Tituj pronesie te njesive ekonomike ku ka interesa pjesmarrese</i>		
<i>Tituj te huadhenies ne njesite ekonomike brenda grupit *</i>		
<i>Tituj te huadhenies ne njesite ekonomike ku ka interesa pjesmarrese</i>		
<i>Tituj te tjere te mbajtur si aktive afatgjate</i>		
<i>Tituj te tjere te huadhenies</i>		
<b>Aktive materiale</b>	4	
<i>Toka dhe ndertesa</i>		
<i>Impiante dhe makineri</i>		
<i>Te tjera instalime dhe pajisje</i>	31,692,950	5,910,235
<i>AAGJM te mbajtura per investim</i>		
<i>Parapagime per aktive materiale dhe ne proces</i>		
<b>Aktivitet biologjike</b>		
<b>Aktive jo materiale</b>		
<i>Koncensione, patenta, licensa, makra tregtare, te drejta dhe aktive te ngjashme</i>		
<i>Emri i mire</i>		
<i>Parapagime per AAJM</i>		
<b>Aktivitet tatimore te shtyra</b>		
<b>Totali i aktiveve afatgjate</b>	<b>31,692,950</b>	<b>5,910,235</b>
<b>TOTALI I AKTIVEVE</b>	<b>43,384,855</b>	<b>6,186,948</b>

**DETYRIMET DHE KAPITALI**



*[Handwritten signature in blue ink]*

**Detyrime afatshkurtra**

5

Titujt e huamarrjes		
Detyrime ndaj institucioneve te kredise		
Aktetime ne avance per porosi		
Te pagueshme per aktivitetin e shfrytezimit	0	0
Deftesa te pagueshme		
Te pagueshme ndaj njesive ekonomike brenda grupit *		
Te pagueshme ndaj njesive ekonomike ku ka interesa pjesmarrese		
Te pagueshme ndaj punonjesve dhe sigurimeve shoqerore/shendetsore	4,646,726	564,828
Te pagueshme per detyrime tatimore	3,179,588	0
Te tjera te pagueshme	18,734,675	4,409,271
<b>Te pagueshme per shpenzime te konstatuara</b>		
<b>Te ardhura te shtyra</b>		
<b>Provizione</b>		
<b>Totali i detyrimeve afatshkurtra</b>	<b>26,560,989</b>	<b>4,974,099</b>

**Detyrime afatgjata**

Titujt e huamarrjes		
Detyrime ndaj institucioneve te kredise		
Aktetime ne avance per porosi		
Te pagueshme per aktivitetin e shfrytezimit		
Deftesa te pagueshme		
Te pagueshme ndaj njesive ekonomike brenda grupit *		
Te pagueshme ndaj njesive ekonomike ku ka interesa pjesmarrese		
Te tjera te pagueshme		
<b>Te pagueshme per shpenzime te konstatuara</b>		
<b>Te ardhura te shtyra</b>		
<b>Provizione</b>		
Provizione per pensione		
Provizione te tjera		
<b>Detyrime tatimore te shtyra</b>		
<b>Totali i detyrimeve afatgjata</b>	<b>0</b>	<b>0</b>

**Detyrime totale****Kapitali dhe Rezervat**

6

<b>Kapitali i nenshkruar</b>	100,000	0
<b>Primi i lidhur me kapitalin</b>		
<b>Rezerva rivleresimi</b>		
<b>Rezerva te tjera</b>	1,212,849	
Rezerva ligjore		
Rezerva statutore		
Rezerva te tjera		
Diferenca nga perkthimi i monedhes ne veprimtari te huaja		
<b>Fitimi/(humbja) e pashperndare</b>		
<b>Fitimi/(humbja) e periudhes</b>	15,511,017	1,212,849
<b>Totali i kapitalit qe i takon pronareve njesise ekonomike</b>	<b>16,823,866</b>	<b>1,212,849</b>
Interesa jo-kontrollues		
<b>Totali i kapitalit</b>	<b>16,823,866</b>	<b>1,212,849</b>
<b>TOTALI I DETYRIMEVE DHE KAPITALIT</b>	<b>43,384,855</b>	<b>6,186,948</b>

Check

0.0

0.0

\* ne rastin e pasqyrave financiare te konsoliduara llogarite me njesite ekonomike brenda grupit eliminohen dhe nuk paraqiten ne





	Shenimet	Periudha Raportuese	Periudha Para ardhese
<b>Te ardhurat nga aktiviteti i shfrytezimit</b>	7		
Te ardhurat nga aktiviteti kryesor		43,920,302	11,003,308
Te ardhurat nga aktiviteti dytesor 1			
Te ardhurat nga aktiviteti dytesor 2			
Te ardhurat nga aktiviteti dytesor 3			
Te tjera te ardhura nga aktiviteti i shfrytezimit		711,748	
<b>Te ardhura nga ndryshimi ne inventarin e mallrave dhe prodhimet ne proces</b>			
<b>Te ardhura nga puna e kryer nga njesia ekonomike per qellimet e veta dhe e kapitalizuar</b>			
<b>Te ardhura te tjera te shfrytezimit</b>			
<b>Lenda e pare dhe materiale te konsumueshme</b>	8		
Lenda e pare dhe materiale te konsumueshme		(4,685,009)	(5,828,889)
Te tjera shpenzime			
<b>Shpenzime te personelit</b>	9		
Paga dhe shperblime		(7,177,200)	(3,053,000)
Shpenzime te sigurimeve shoqerore/shendetsore		(1,198,592)	(510,000)
Shpenzimet per pensionet			
<b>Zhvleresimi i aktiveve afatgjata materiale</b>			
<b>Shpenzime konsumi dhe amortizimi</b>	4		
Shpenzime te tjera shfrytezimi	10	(4,931,512)	(98,504)
<b>Te ardhura te tjera</b>		(7,563,580)	(296,000)
Te ardhura nga njesite ekonomike brenda grupit*			
Te ardhura nga njesite ekonomike ku ka interesa pjesmarrese			
Te ardhura nga investimet dhe huate e tjera ne njesi ekonomike brenda grupit, pjese e aktiveve afatgjata *			
Te ardhura nga investimet dhe huate e tjera ne njesi ekonomike ku ka interesa pjesmarrese, pjese e aktiveve afatgjata			
Interesa te arketueshem dhe te ardhura te tjera te ngjashme nga njesi ekonomike brenda grupit *			
Interesa te arketueshem dhe te ardhura te tjera te ngjashme nga njesi ekonomike ku ka interesa pjesmarrese			
<b>Zhvleresim i aktiveve financiare dhe investimeve financiare te mbajtura si aktive afatshkurtra</b>			
<b>Shpenzime financiare</b>	11		
Shpenzime interesi dhe shpenzime te ngjashme			
* Shpenzime te tjera financiare		(160,893)	(4,066)
<b>Pjesa e fitimit/(humbjes) financiare nga pjesmarrjet</b>			
<b>Te tjera (pershkruaj)</b>			
<b>Fitimi/(humbja) para tatimit</b>		18,915,264	1,212,849
<b>Tatimi mbi fitimin</b>	12		
Tatimi mbi fitimin e periudhes		(3,404,247)	
Tatim fitimi i shtyre			
Pjesa e tatim fitimit te pjesemarrjeve			
<b>Fitimi/(Humbja) e periudhes/vitit (A)</b>		15,511,017	1,212,849
<b>Te ardhura te tjera gjitheperfshirese per periudhen/vitit:</b>			
Diferenca (+/-) nga perkthimi i monedhes ne veprimari te huaja			
Diferenca (+/-) nga rivleresimi i aktiveve afatgjata materiale			
Diferenca (+/-) nga rivleresimi i aktiveve financiare te mbajtura per shitje			
Pjesa e te ardhurave gjitheperfshirese nga pjesmarrjet			
<b>Te tjera (pershkruaj)</b>			
<b>Totali i te ardhurave te tjera gjitheperfshirese per periudhen/vitit (B)</b>			
<b>Totali i te ardhurave gjitheperfshirese per periudhen/vitit (A+B)</b>		15,511,017	1,212,849
<b>Totali i te ardhurave gjitheperfshirese per :</b>			
Pronaret e njesise ekonomike meme			
Interesat jo-kontrollues			

\* ne rastin e pasqyrave financiare te konsoliduara llogarite me njesite ekonomike brenda grupit eliminohen dhe nuk paraqiten ne pasqyren e performances



*[Handwritten signature]*

# PASQYRAT FINANCIARE 2020

SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE  
PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2020

## I. Informacione te pergjitheshme

Shoqëria "Pati Travel" shpk është rregjistruar në QKB me 22.02.2017 me nipt L71422015F. Me ortak te vetem z. Patriot Rexhmati dhe me kapital fillestar ne shumen 100.000 leke. Ne vitin 2017 deri ne fillim te vitit 2020 ka qene e regjistruar ne tatime si subjekt I tatimit te thjeshtuar mbi fitimin dhe ne vitin 2020 ka kaluar si subjekt I tatimit mbi fitimin.

Veprimtaria kryesore shoqërisë për vitin ushtrimor 2020 ka transporti kombtar dhe nderkombtare udhetresh dhe mallrash për vete dhe për te trete.

## II. Deklaratë e pajtueshmërisë me SKK-të

Pasqyrat financiare (individuale) për qëllime të përgjithshme janë përgatitur dhe paraqiten në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK-të), të përmirësuara, dhe me kërkesat e Ligji 25/2018 date 10.05.2018 PËR KONTABILITETIN DHE PASQYRAT FINANCIARE.

## III. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazen e parimit të kostos historike, duke e kombinuar me elemente të metodave të tjera, dhe parimit të drejtave të kostatuara. Ato paraqiten në monedhën vendase, Lekë Shqiptar (lekë).

## IV. Politikave më të rëndësishme kontabël të zbatuara:

### Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë, mjete monetare në arkë dhe bankë, llogari rrjedhëse, si dhe, investime në tregun e parasë dhe tregje të tjera shumë likuide me kontrata jo më të gjata se tre muaj, të cilat janë objekt i një rreziku jo domethënës të ndryshimeve në vlerë.

Flukset monetare janë hyrjet ose daljet e mjeteve monetare dhe ekuivalentët e mjeteve monetare.

### Aktivitet dhe detyrimet financiare

Një aktiv financiar ose një detyrim financiar njihet vetëm kur shoqëria bëhet pjesë e kushteve kontraktuale të instrumentit. Matja fillestare e një aktivi financiar ose një detyrim financiar bëhet me kostot e transaksionit (duke përfshirë edhe çmimin e transaksionit) përveç rasteve kur marrëveshja përbën në thelb, një transaksion financiar. Instrumentat e borxhit që janë të klasifikuara si aktive afatshkurtër ose detyrime afatshkurtër maten me shumën e paskontuar të mjeteve monetare ose shumave të tjera të pritshme për t'u paguar ose arkëtuar, përveçse kur marrëveshja përbën, në efekt, një transaksion financiar. Nëse marrëveshja përbën një transaksion financiar, matja e instrumentit të borxhit bëhet me vlerën aktuale të pagesave të ardhshme të skontuara me një normë tregu interesi për një instrument të ngjashëm borxhi.

Në fund të çdo periudhe raportimi, shoqëria vlerëson nëse ka një evidencë objektive të zhvlerësimit të ndonjë aktivi financiar që matet me kosto ose me kosto të amortizuar. Aktivitet dhe detyrimet financiar shoqëria i klasifikon në afatshkurtra dhe afatgjata, bazuar në percaktimet e SKK-2.



## Inventarët

Fillimisht, inventari njihet atëhere kur shoqëria e ka nën kontroll, pret përfitime ekonomike prej tij dhe kostoja e tij mund të vlerësohet me besueshmëri. Njohja e inventarëve bëhet zakonisht në momentin e përfitimit.

Inventarët maten fillimisht me kosto.

Pas njohjes, inventari matet me vlerën më të ulët midis koston dhe çmimit të vlerësuar të shitjes pakësuar me koston për t'u përfunduar dhe shitur.

Inventarët i nënshtrohen testit të zhvlerësimit në datën e raportimit.

## Shpenzimet e shtyra dhe të arkëtueshme nga të ardhurat e konstatuara

Shoqëria zbaton politikat e shtyrjes të shpenzimeve të cilat do të sigurojnë të ardhura në periudhat e mëvonshme. Po ashtu ajo shpërndan shpenzimet e parapaguara në vartësi të përdorimit dhe sigurimit të të ardhurave.

## Aktivitet afatgjata materiale

Aktivitet afatgjata materiale(AAM-të) njihen si një aktiv vetëm nëse: aktivi kontrollohet nga shoqëria, është e mundur që përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i aktivitet të hyrë dhe kostoja e aktivitet mund të matet me besueshmëri. Regjistrimi fillestar i AAM-së bëhet zakonisht në momentin e përfitimit të tij nga blerja apo prodhimi. Në vlerësimin e mëpasshëm shoqëria zbaton si politikë të saj kontabël modelin e koston dhe e aplikon këtë model për të gjithë klasën e AAM-së që vlerësohet.

Në pasqyrën e pozicionit financiar një element i AAM-së paraqitet me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe ndonjë humbje të akumuluar nga zhvlerësimi.

Shoqëria vlerëson në çdo datë të raportimit nëse ka ndonjë shenjë që një aktiv mund të jetë i zhvlerësuar. Nëse ekziston ndonjë shenjë e tillë, ajo vlerëson shumën e rikuperueshme të aktivitet. Nëse nuk ka të shenja për zhvlerësim, nuk është e nevojshme të vlerësohet shumta e rikuperueshme.

Vlera e amortizueshme e AAM-ve njihet në pasqyrën e të ardhurave, si shpenzim në mënyrë sistematike përgjatë jetës së dobishme të këtij aktivitet. Përfshirje bëjnë aktivitet afatgjata materiale me jetë të dobishme pa afat si për shembull, toka (përveç minierave dhe vendeve të përdorura për groposje), punimet e artit me jetë afatgjatë, veprat e muzeve dhe librat të cilat nuk amortizohen.

Amortizimi për të gjitha grupet, llogaritet dhe njihet me *metodën e vlerës së mbetur*, me norma të cilat janë të përafërta me jetegjatesinë mesatare të parashikuar të përdorimit. Toka dhe aktivitet në proces nuk amortizohen. Normat e përdorura për astete e vitit 2020 janë 20% të vlerës së mbetur.

## Njohja e të ardhurave dhe shpenzimeve

Të ardhurat dhe shpenzimet njihen sipas kontabilitetit të të drejtave të konstatuara. Matja e të ardhurave bëhet me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme. Vlera e drejtë e shumës së arkëtuar apo për t'u arkëtuar merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

Të ardhurat nga shitja e mallrave dhe e produkteve njihen kur janë plotësuar të gjitha kushtet e mëposhtme: i janë kaluar blerësit të gjitha rreziqet dhe përfitimet, që lidhen me pronësinë e mallrave dhe produkteve; shoqëria nuk vazhdon të jetë e përfshirë në mënyrë të vazhdueshme në menaxhimin e mallrave dhe të produkteve në atë masë që tregon se ende zotëron titullin e pronësisë dhe/ose ka kontroll efektiv mbi mallrat/produktet e shitura; shumta e të ardhurave mund të matet me besueshmëri; është e mundur që përfitimet ekonomike, që lidhen me transaksionin, do të merren; koston që kanë ndodhur, ose që do të ndodhin në lidhje me transaksionin, mund të maten me besueshmëri.



## PASQYRAT FINANCIARE 2020

Të ardhurat nga kryerja e shërbimeve njihen kur: shuma e të ardhurave mund të matet me besueshmëri; është e mundshme që përfitimet ekonomike të lidhura me transaksionin do të hyjnë në shoqëri; faza e përfundimit të transaksionit në fund të periudhës raportuese mund të matet me besueshmëri; kostot e ndodhura për shërbimin, si dhe ato që do të ndodhin për përfundimin e tij mund të maten me besueshmëri.

Shpenzimet njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve atëherë kur ngjarja detyruese ka ndodhur dhe shoqëria pret të dalin aktive për shlyerjen e tyre në të ardhmen. Shoqëria zbaton parimin e krahasimit të të ardhurave me shpenzimet brenda të njëjtit ushtrim kontabel. Shpenzimet njihen kur kryhen dhe realizohen të ardhura prej tyre, pavarësisht nëse janë faturuar apo paguar.

### Transaksionet me monedhat e huaja

Transaksionet në monedhë të huaj, që plotesojnë kushtet në njohje, regjistrohet në monedhën funksionale, duke zbatuar mbi shumën e monedhës së huaj kursin e menjëhershëm të këmbimit (spot) ndërmjet monedhës funksionale dhe monedhës së huaj në datën e transaksionit, por shpesh përdoret një kurs këmbimi, i cili është i përafërt me kursin e datës së kryerjes së transaksionit, p.sh. një kurs mesatar i një jave ose një muaji mund të përdoret për të gjitha transaksionet e kryera gjatë kësaj periudhe, në secilën prej monedhave të përdorura.

Në fund të çdo periudhe raportuese, zërat në monedhë të huaj përkthehen si me poshtë: zërat monetarë të shprehur në monedhë të huaj duke përdorur kursin e këmbimit të mbylljes (d.m.th. në datën raportuese); zërat jomonetarë që maten me kosto historike në monedhë të huaj duke përdorur kursin e këmbimit në datën e transaksionit; zërat jomonetarë që maten me vlerën e drejtë në monedhë të huaj duke përdorur kursin e këmbimit në datën kur është përcaktuar vlera e drejtë.

Diferencat e këmbimit, që krijohen gjatë shlyerjes së zërave monetarë ose gjatë përkthimit të zërave monetarë me kurse këmbimi të ndryshme nga kurset e këmbimit, me të cilat ato janë përkthyer në njohjen gjatë periudhës kontabel aktuale, ose në pasqyrat financiare të mëparshme, njihen si fitim (ose humbje) të periudhës kontabel kur ato lindin.

Kur një përfitim ose humbje për një zë jomonetar njihet drejtpërdrejt në kapital, atëherë drejtpërdrejt në kapital do të njihet edhe diferenca e këmbimit.

Kurset e këmbimit, të përdorura nga shoqëria për monedhat e huaja më kryesore, më 31.12.2020 janë 1 euro=123.7 leke dhe 1 dollar=100.84 leke.

### Tatimi mbi fitimin

Tatimi mbi fitimin përfshin tatimin e periudhës aktuale dhe tatimin e shtyrë. Tatimi mbi fitimin njihet si shpenzim tatimor në pasqyrën e performancës, përveç tatimit të zërave që njihen direkt në kapital, i cili njihet si një zë i kapitalit.

Detyrimi tatimor aktual njihet në vlerat që shoqëria pritet të paguajë (rimbursojë) mbi bazën e normave tatimore dhe ligjeve tatimore që janë miratuar ose janë në thelb të miratuara në datën e raportimit.

Aktivi ose detyrimi tatimor të shtyrë njihet për tatimet e zbritshme (rimbursueshme) ose të pagueshme në periudhat e ardhshme si rezultat i transaksioneve ose ngjarjeve të kaluara. Këto tatime lindin nga ndryshimet mes vlerave të njohura për aktivet dhe detyrimet në pasqyrën e pozicionit financiar dhe njohjes së këtyre aktiveve dhe detyrimeve nga autoritetet tatimore, si dhe nga mbartja e humbjeve tatimore dhe e tatimit të zbritshëm (rimbursueshëm) të papërdorur.

Norma aktuale e tatimit mbi fitimin për ushtrimin 2020 është 15 % dhe 5% duke qene se gjate vitit 2020 kaloi nga biznes i bogel ne biznes i madh.

# PASQYRAT FINANCIARE 2020

## V. Shpjegim per zera te ndryshem ne Pasqyrat Financiare.

### 1. Mjete Monetare (likujditete në arke, bankë etj.)

Gjendjet e mjetet monetare ne banke dhe arke, ne fillim dhe fund te ushtrimit jane si me poshte:

Nr.	Përshkrimi i Elementëve	Viti raportues 31.12.2020		Viti raportues 31.12.2019	
1	Mjetet monetare ne arke	389,164	Leke	-	Leke
2	Mjetet monetare ne banke	4,326,477	Leke	253,025	Leke
	<b>Shuma</b>	<b>4,715,641</b>	<b>Leke</b>	<b>253,025</b>	<b>Leke</b>

Gjendjet e llogarive të likujditeteve të paraqitura ne pasqyrat financiare konfirmohen me nxjerrjet e llogarive bankare dhe inventaret fizike te monedhave ne fund të ushtrimit. Tepricat e shprehura në monedhë të huaj, jane përkthyer ne leke duke përdorur kursin e këmbimit të shpallur nga Banka e Shqipërisë.

### 2. Të Drejta të Arkëtueshme Afatshkurtëra

Të drejtat e arketueshme, në fillim dhe në fund të ushtrimit kontabël deklarohen si vijon:

Nr.	Përshkrimi i Elementëve	Viti raportues 31.12.2020		Viti raportues 31.12.2019	
1	Kerkesa te arketueshme (klikekte)	-	Leke	-	Leke
2	Shteti - llogari doganore	8,247	Leke	-	Leke
3	Shteti - TVSH e zbritshme	6,944,245	Leke	-	Leke
	<b>Shuma</b>	<b>6,952,492</b>	<b>Leke</b>	<b>-</b>	<b>Leke</b>

Te drejtat e arketueshme jane te drejta ndaj klienteve per shitje te finalizuara dhe te pa arketuara si dhe te drejta ndaj shtetit dhe konkretisht pardhenje ne doganore dhe te drejta per TVSH. Drejtimi mendon se të gjitha kerkesat do të mbarten dhe do te zbriten ne periudhen e ardhshme vitin 2021.

### 3. Inventari

Gjendjet e inventarit ne fillim dhe fund te ushtrimit paraqiten:

Nr.	Përshkrimi i Elementëve	Viti raportues 31.12.2020		Viti raportues 31.12.2019	
1	Mallra per shitje	23,772	Leke	23,688	Leke
	<b>Shuma</b>	<b>23,772</b>	<b>Leke</b>	<b>23,688</b>	<b>Leke</b>

Vlerat e inventarit te paraqitura me siper perputhen me te dhenat e kontabilitetit dhe te inventarizimeve fizike e kryer ne fund te ushtrimit 2020. Si politike kontabel ne percaktimin e kosos se inventarit eshte perdorur metoda "mesatares se ponderuar".

Shuma e inventarit te paraqitur ne "Mallra" perfaqson mallrat qe jane blere per tu tregtuar, ne fund te vitit jane vleresuar me koston mesatare te ponderuar.

Drejtimi mendon se vlera e paraqitur eshte vlera me e ulet mes kosos se marrjes dhe vleres neto te realizueshme dhe nuk eshte nevoja per zhvleresime te tij.



## PASQYRAT FINANCIARE 2020

### 4. Aktivët Afatgjata Materiale(AAM-te)

Kostoja, amortizimi i akumuluar dhe vlera kontabël në fillim dhe në fund të vitit ushtrimor për aktivët afatgjata materiale(AAM-të) paraqiten si vijon:

	Gjendjet dhe levizjet	Toka	Ndertesa	Makineri dhe pajisje zyre	Mjete transporti	Kompjuterike	Totali
A	Kosto e AAM-ve me 01.01.2020	-	-	-	6,008,739	-	6,008,739
	Shtesat	-	-	-	31,561,227	-	31,561,227
	Pakesimet	-	-	-	(847,000)	-	(847,000)
	<b>Kosto e AAM-ve 31.12.2020</b>	-	-	-	<b>36,722,966</b>	-	<b>36,722,966</b>
B	Amortizimi AAM-ve 01.01.2020	-	-	-	98,504	-	98,504
	Amortizimi ushtrimit	-	-	-	4,931,512	-	4,931,512
	Amortizimi per daljet e AAM-ve	-	-	-	-	-	-
	<b>Amortizimi i AAM-ve 31.12.2020</b>	-	-	-	<b>5,030,016</b>	-	<b>5,030,016</b>
C	Zhvlresimi AAM-ve 01.01.2018	-	-	-	-	-	-
	Shtesat	-	-	-	-	-	-
	Pakesimet	-	-	-	-	-	-
	<b>Zhvlresimi AAM-ve 31.12.2020</b>	-	-	-	-	-	-
D	Vlera neto e AAM-ve 01.01.2020	-	-	-	5,910,235	-	5,910,235
	<b>Vlera neto e AAM-ve 31.12.2020</b>	-	-	-	<b>31,692,950</b>	-	<b>31,692,950</b>

AAM-të, që plotësojnë kriteret për njohje si aktiv në pasqyrën e pozicionit financiar, janë matur me kosto. Në vlerësimin e mëpasshëm shoqëria zbaton si politikë të saj kontabël modelin e koston dhe në pasqyrën e pozicionit financiar AAM-të janë paraqitur me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe ndonjë humbje të akumuluar nga zhvlrësimi, nëse ka.

Vlerat dhe klasifikimi ne grupe i AAM-ve te pasqyruara ne bilanc dhe ne tabelen e mesiperme jane te perputhura me te dhenat e inventarizimeve fizike qe shoqeria e ka kryer ne fund te muajit dhjetor 2020.

Metoda e zgjedhur e amortizimit të AAM-ve është metoda mbi vlerën e mbetur, e njëjtë me atë që perdoret per qellime fiskale.

Shoqëria vlerëson në çdo datë të raportimit nëse ka ndonjë shenjë që një aktiv mund të jetë i zhvlrësuar. Drejtimi mendon se përgjithësisht në këtë ushtrim kontabël, nuk ka shenja të rënjes në vlerë të AAM-ve dhe nuk ka llogaritur zhvlrësime.

### 5. Detyrime Afatshkurtëra

Detyrimet afatshkurtera ne fillim dhe ne fund te ushtrimit kontabel 2020 paraqiten:

Nr.	Përshkrimi i Elementëve	Viti raportues 31.12.2020		Viti raportues 31.12.2019	
1	Të Pagueshme për Aktivitetin e Shfrytëzimit , Furnitoret	-	Leke	-	Leke
2	Paga dhe shpërblime	4,451,147	Leke	429,792	Leke
3	Sigurime shoqërore dhe shëndetësore	195,579	Leke	135,036	Leke
4	Shteti - Tatim mbi pagën	26,000	Leke		Leke
5	Shteti - Tatim mbi fitimin	3,153,588	Leke		Leke
6	Detyrime ndaj ortakeve	18,734,675	Leke	4,409,271	Leke
	<b>Shuma</b>	<b>26,560,989</b>	<b>Leke</b>	<b>4,974,099</b>	<b>Leke</b>

## PASQYRAT FINANCIARE 2020

"Të Pagueshme për Aktivitetin e Shfrytëzimit (furnitore)" pasqyron detyrimet ndaj furnitoreve për blerjen e mallrave e shërbimeve pa u likujduar në fund të ushtrimit. Drejtimi mendon se të drejtat e furnitoreve janë të vlerësuara realisht dhe të konfirmuara me furnitorët.

"Të Pagueshme ndaj Punonjësve dhe Sigurime shoq./shëndet." paraqet detyrimet e mbetura pa u paguar ndaj personelit dhe shtetit të cilat paguhen në janar 2021.

"Të Pagueshme ndaj shtetit." paraqet detyrimet që ka shoqëria ndaj shtetit për TVSH-ne, taimin mbi fitimin të cilat paguhen në 2021.

### 6. Kapitali dhe rezervat

Kapitali i regjistruar i shoqërisë, i paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar, është i njëjtë me atë të përcaktuar në statutin e shoqërisë dhe vendimet e depozituara në QKR.

Me vendim të ortakut të vetëm, fitimi i vitit 2019, është destinuar për rezerva të tjera. Konkretisht zërat të cilët përbejnë kapitalin dhe rezervat janë si më poshtë.

Nr.	Përshkrimi i Elementëve	Viti raportues 31.12.2020		Viti raportues 31.12.2019	
1	Kapital i nënshkruar	100,000	Leke	-	Leke
2	Rezerva të ndryshme	1,212,849	Leke	-	Leke
3	Fitim (humbja) e periudhës	15,511,017	Leke	1,212,849	Leke
	<b>Shuma</b>	<b>16,823,866</b>	<b>Leke</b>	<b>1,212,849</b>	<b>Leke</b>

### 7. Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit dhe të tjera

Te ardhura e realizuara gjatë ushtrimit, sipas segmenteve (kategorive) të biznesit paraqitet si vijon:

Nr.	Përshkrimi i Elementëve	Viti raportues 2020		Viti raportues 2019	
1	Te ardhura nga shitjet	43,920,302	Leke	11,003,308	Leke
2	Te ardhura nga shitjet A.Q	711,748	Leke	-	Leke
	<b>Shuma</b>	<b>44,632,050</b>	<b>Leke</b>	<b>11,003,308</b>	<b>Leke</b>

Te ardhurat kryesore të shoqërisë janë të ardhurat nga transporti u udhetareve brenda dhe jashtë vendit të cilat janë vlerësuar me vlerën e drejtë të shumës së arkëtuar ose të arkëtueshme, duke marrë parasysh shumën e skontimeve ose rabatet e ofruara, të zhveshura nga TVSH-Ja. Te ardhurat të tjera për vitin 2020 është shitja e një makine të cilën shoqëria e ka pas të klasifikuar si aktiv afatgjat material.

Shënim: Sic e kemi thënë edhe më sipër shoqëria në vitin 2020 ka kaluar nga biznesi i tatimit të thjeshtuar mbi fitimin në biznesin e tatimit mbi fitimin për këtë arsye ajo ka ndarë të ardhurat dhe shpenzimet sipas llojit të tatimit dhe periudhës që i takojnë. Konkretisht të ardhurat e vitit 2020 janë 44.632.050 leke nga të cilat 5.096.233 leke i parkasin pjesës së tatimit të thjeshtuar dhe 39.535.817 leke i parkasin pjesës së tatimit mbi fitimin.

### 8. Shpenzimet e për lëndë të parë dhe materiale të konsumueshme

Materialet dhe mallrat e konsumuara të pasqyruar në pasqyrën e performancës analizohen si vijon:



## PASQYRAT FINANCIARE 2020

Nr.	Përshkrimi i Elementëve	Viti raportues 2020		Viti raportues 2019	
1	Blerje mallra dhe lende te para	184,800	Leke	5,828,889	Leke
2	Taksa doganore	13,543	Leke	-	Leke
3	Mirembajtje dhe riparime makinash	1,368,776	Leke	-	Leke
4	Siguracione makine	791,418	Leke	-	Leke
5	Karburant	2,320,411	Leke	-	Leke
6	Taksa mjetesh	6,145	Leke	-	Leke
7	Ndryshim ne gjendjen e inventarit	(84)	Leke	-	Leke
	<b>Shuma</b>	<b>4,685,009</b>	<b>Leke</b>	<b>5,828,889</b>	<b>Leke</b>

Shpenzimet per lende te para dhe materiale te konsumueshme eshte kosto konsumuar nga shoqeria ne menyre direkte per krijimin e te ardhutave.

### 9. Shpenzime personeli

Shpenzimet e personelit përbehen nga pagat, kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, leja vjetore e paguar, raporti mjekësor i paguar në 14 ditët e para, pjesëmarrja në fitime dhe shpërblimet. Shpenzimet vjetore të kryera për personelin janë si me poshtë :

Nr.	Përshkrimi i Elementëve	Viti raportues 2020		Viti raportues 2019	
1	Paga dhe Shpërblime	7,177,200	Leke	3,053,000	Leke
2	Shpenzime për Sigurimet	1,198,592	Leke	510,000	Leke
	<b>Shuma</b>	<b>8,375,792</b>	<b>Leke</b>	<b>3,563,000</b>	<b>Leke</b>

Numri mesatar i punonjesve ne shoqeri eshte shume i rendesishem pasi ai ndikon dhe ne klasifikimin e subjektit bazuar ne ligjin e ri per kontabilitetin. Numri mesatar i punonjesve per vitin 2020 eshte 16 persona.

### 10. Shpenzime të tjera shfrytëzimi

Në shpenzime të tjera të shfrytëzimit janë përfshirë kostot e shërbimeve kryesore dhe ndihmëse, që lidhen drejtpërdrejt me veprimtaritë e shfrytëzimit dhe ato për qëllime administrative, si dhe, kostot që ndodhin jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të biznesit paraqiten si me poshte.

Nr.	Përshkrimi i Elementëve	Viti raportues 2020		Viti raportues 2019	
1	Qirate	720,000	Leke	240,000	Leke
2	Mirembajtje dhe riparime kase	10,000	Leke	-	Leke
3	Gjoha e demshperblime	5,986,580	Leke	-	Leke
4	Vlera kontabel e aktiveve te shitura	847,000	Leke	-	Leke
5	Taksa dhe tarifa vendore	-	Leke	56,000	Leke
	<b>Shuma</b>	<b>7,563,580</b>	<b>Leke</b>	<b>296,000</b>	<b>Leke</b>

## PASQYRAT FINANCIARE 2020

### 11. Te ardhurat dhe shpenzimet financiare

Jane paraqitur si diference e te ardhurave me shpenzimet sipas kerkesave te standarteve. Si shpenzime financiare per vitin 2020 shoqeria ka patur shpenzime komisione bankare si diferenca nga kurset e kembimit valutor. Shumat perkatese jane si me poshte:

Nr.	Përshkrimi i Elementëve	Viti raportues 2020		Viti raportues 2019	
1	Komisionet	97,978	Leke	4,066	Leke
2	Diferencat e kursit te kembimit	62,915	Leke	-	Leke
	<b>Shuma</b>	<b>160,893</b>	<b>Leke</b>	<b>4,066</b>	<b>Leke</b>

### 12. Shpenzimet e tatimit mbi fitimin

Ne vijim janë pasqyruar përbërësit më kryesorë të shpenzimeve (të ardhurave) tatimore të cilat përfshijnë: shpenzimet tatimore aktuale dhe shumën e shpenzimit (të ardhurës) tatimore të shtyrë, që ka të bëjë me krijimin dhe realizimin e diferencave të përkohshme dhe mbartjen e humbjeve. Ne llogaritjen e tatimit korrekt që i takon shoqerise jane shtuar edhe shpenzimet e pa njohura, konkretisht keto zera jane si me poshte vijon:

Nr.	Përshkrimi i Elementëve	Viti raportues 2020		Viti raportues 2019	
1	Fitim (humbja) para tatimit	18,915,264	Leke	1,212,849	Leke
2	Humbje tatimore e mbartur	-	Leke	-	Leke
3	Shpenzime te pa njohura	6,121,832	Leke	-	Leke
	<b>Shpenzime te tatim fitimit 15%</b>	<b>3,404,247</b>	<b>Leke</b>	<b>-</b>	<b>Leke</b>

Ne vitin 2020 shoqeria kaloi nga subjekt i tatimit te thjeshtuar mbi fitimin ne tatim mbi fitimin per kete arsye ajo deklaroi dhe llogariti tatimin perkates per te dy deklaratat e tatimit. Konkretisht keto deklarata jane permbledhur ne tabelen e me poshteme:

Nr.	Përshkrimi i Elementëve	Viti raportues 2020		Tatimi i thjeshtuar		Tatim fitimi	
1	Te ardhurat nga shitjet	44,632,050	Leke	5,096,233	Leke	39,535,817	Leke
1	Shpenzimet	(25,716,786)	Leke	(1,583,056)	Leke	(24,133,730)	Leke
1	Fitim (humbja) para tatimit	18,915,264	Leke	3,513,177	Leke	15,402,087	Leke
2	Humbje tatimore e mbartur	-	Leke	-	Leke	-	Leke
3	Shpenzime te pa njohura	6,121,832	Leke	-	Leke	6,121,832	Leke
	<b>Shpenzime te tatim fitimit</b>	<b>3,404,247</b>	<b>Leke</b>	<b>175,659</b>	<b>Leke</b>	<b>3,228,588</b>	<b>Leke</b>



## PASQYRAT FINANCIARE 2020

Në llogaritjen e shpenzimit aktual të tatimit mbi fitimin janë respektuar kerkesat e legjislacionit fiskal. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2020 është 5 % për tatimin e thjeshtuar mbi fitimin dhe 15% për tatimin mbi fitimin. Për këtë vit ushtrimor nuk është njohur aktiv tatimor i shtyrë .

### 13. Ngjarjet pas dates se bilancit dhe vazhdimësia e shfrytëzimit

Asnjë ngjarje e rëndësishme nuk ka ndodhur pas datës së miratimit të pasqyrave financiare.

### 14. Shpjegime mbi palët e lidhura

Me marrjen në konsideratë të çdo transaksioni dhe marrëdhënie të mundshme, jo thjesht formen ligjore të tyre në 31 dhjetor 2020 dhe 31 Dhjetor 2019 nuk ka transaksione me palët e lidhura.

### 15. Shifrat krahasuese

Pasqyrat financiare të vitit 2020 janë hartuar dhe paraqitur në përputhje me formatet që janë dhënë në shtojcën e standardit SKK-2, (të përmirësuar) dhe çeljet e vitit 2019 janë riparaqitur sipas këtyre zërave.

Administratori

Patriot Rexhmati

*Patriot Rexhmati*



*PR*

Hartuesi / Financieri

Dorian Fishti

*Dorian Fishti*